

FJALA E GUVERNATORIT

Të dashur lexues,

Në përmbushje të detyrimeve tona ligjore për transparencë dhe llogaridhënie, Raporti Vjetor që keni në duar vjen tek ju si një pasqyrë e aktivitetit të Bankës së Shqipërisë gjatë vitit të shkuar.

Si autoriteti monetar dhe institucioni përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit bankar në Shqipëri, Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, për mbështetjen e stabilitetit financiar, për emetimin dhe qarkullimin e monedhës kombëtare, për nxitjen e kreditit dhe zhvillimin e sistemit të pagesave, si dhe për detyra të tjera që i shërbejnë zhvillimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit.

Puna jonë gjatë vitit 2017 u konkretizua në rezultate të preکشme, në të gjitha fushat e veprimtarisë sonë.

Në fushën ekonomike, politika jonë monetare stimuluese ka ushqyer kërkesën agregate dhe rritjen ekonomike, ka ndihmuar rritjen e punësimit dhe përmirësimin e bilanceve financiare të aktorëve ekonomikë, si dhe ka krijuar premisa për kthimin e inflacionit në objektiv brenda horizontit afatmesëm.

Në fushën financiare, mbikëqyrja e kujdesshme dhe përçasja proaktive ndaj rregullimit bankar, kanë ndihmuar përmirësimin e gjithanshëm të parametrave të shëndetit të sektorit bankar dhe kanë rritur aftësinë e tij për ndërmjetësim financiar. Në veçanti, aksioni për zbutjen e kredive me probleme vijoi të japë rezultate, duke thuarjse përgjysmuar këtë tregues në harkun kohor të tre viteve.

Për të rritur sigurinë e sistemit financiar dhe në kuadër të interesit publik, Banka e Shqipërisë krijoi rregullore të reja, me procedura të mirëpërcaktuara për të qenë e gatshme për të ndërhyrë dhe ristrukturuar bankat që mund të jenë në vështirësi paguese. Po ashtu, në mbështetje të stabilitetit financiar, ne kemi vijuar të bashkëpunojmë me të gjithë partnerët tanë, të brendshëm e të jashtëm, për shkëmbimin e informacionit dhe për rritjen e koordinimit dhe efektivitetit të masave tona.

Në mbështetje të zhvillimit ekonomik e financiar të vendit, kemi vijuar punën për funksionimin sa më eficient të sistemeve të pagesave. Këtë vit është punuar për përmirësimin e kuadrit rregullator të shërbimeve të pagesave, të cilat rrisin transparencën për shërbimet e ofruara dhe forcojnë bazën ligjore për mbrojtjen e konsumatorit. Përmirësimi i këtyre aspekteve ndihmon në zgjerimin e përfshirjes financiare të popullatës, kategori ku Shqipëria ka renditje të ulët.

Krahas këtyre fushave, Banka ka vijuar të jetë një kontribues aktiv në përmbushjen e kriterëve të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian, në standardizimin dhe unifikimin e statistikave të prodhuara me standardet ndërkombëtare, si dhe në edukimin financiar të publikut që në moshat e reja. Një risi e këndshme gjatë këtij viti ka qenë seria e takimeve “Netët e Muzeut”, ku akademikë nga fusha të ndryshme, kanë mbajtur leksione të lidhura me çështje të numizmatikës dhe koleksionimit.



Në filozofinë e saj të komunikimit, Banka e Shqipërisë synon të jetë e hapur dhe të promovojë bashkëpunimin, shkëmbimin e opinioneve dhe ofrimin e informacionit. Ky vit ka shënuar një sërë aktivitesh ku është përfshirë si publiku profesional dhe publiku më i gjerë. Gjithashtu, janë nënshkruar memorandume të rëndësishme bashkëpunimi, ku do të veçoja atë me autoritetet e vendit për rritjen e përdorimit të monedhës vendase në sistemin financiar dhe në ekonomi.

Në fund të vitit 2017, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi strategjinë afatmesme të institucionit për tre vitet e ardhshme. Kjo strategji shpreh ambicjet tona për t'u zhvilluar dhe për të përparuar sipas standardeve më të mira ndërkombëtare. Dokumenti është një shprehje konkrete e filozofisë sonë proaktive ndaj sfidave të ambientit ku funksionon Banka e Shqipërisë.

Së fundi, siç është bërë tashmë traditë, më lejoni të evidentoj dhe falënderoj stafin punonjës e drejtues të Bankës së Shqipërisë: përkushtimi dhe profesionalizmi i tyre ka qenë dhe do të vijojë të mbetet garancia reale e suksesit të punës sonë.

Me respekt,

Gent Sejko

Gubernur

